



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 4500/3 Prot.

Pogradec, më 23.12.2025

VENDIM

Nr. 145, datë 22.12.2025

“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR Z. BEQIR RUSI, FAMILJE QË KA PËSUAR DËME NË ORENDI, PAJISJE DHE TE ANES NDERTIMORE SI PASOJË E PËRMBYTJES NE BANESE”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 30 gërma “gj”, të Ligjit nr. 45, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile”, Kreut III, pika 1, shkronja “ë”, të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Të akordojë ndihmën financiare për z. Beqir Rusi, shumë prej **160689.62** (njqind e gjashtedhjetë mije e gjashteqind e tetëdhjetë e nente) lekë, familje që ka pësuar dëme në orendi dhe pajisje elektroshtëpiake si pasojë e përmbytjes në banesë nga rënia e shirave të rrëmbyeshëm.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga komisioni përkatës pranë Bashkia Pogradec.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës 1, të këtij vendimi, të përballohen nga Fondi i Emergjencave Civile, të parashikuar në Buxhetin e vitit 2025, të Bashkisë Pogradec.



4. Ndihma financiare që do të akordohet, do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit z. Beqir Rusi, banesa e të cilës është dëmtuar nga rënia e shirave të rrëmbyeshëm.
5. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve si dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Pogradec, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT

Albana PRIFTI

1. Miratuar me 25 vota

2. Vota Pro 25

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 23.12.2025

